



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 578/5 prot

Datë 12.03.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 267/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.03.2024 me:

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-97355-03-05-2024 me objekt “Blerje materiale kancelarie”, me fond limit 2,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “ Interlogistic” SHPK me NIPT K21605003M dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga dytësore km.9, Godinë 3 katëshe.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vau Dejës  
Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejes.

**Baza Ligjore:** Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Nenet 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi Paraparak*

I.1. Vlera limit e përlloritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nënit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.03.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-97355-03-05-2024, me objekt “Blerje materiale kancelarie”, me fond limit 2,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.

II.2. Në datën 07.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 578/2024 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3874, e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1228/6 prot., datë 11.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 578/2 prot., datë 11.03.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i personit të autorizuar për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik ankimes “Interlogistic” SHPK.

II.5. Referuar Vendimit me nr. 1228/6 prot., datë 11.03.2024, të personit të autorizuar për shqyrtimin e ankesës, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar Vendimit me nr. 1228/6 prot., datë 11.03.2024, të personit të autorizuar për shqyrtimin e ankesës, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, me arsyetimin se:

*[...] Gjate shqyrtimit, konstatoi se eshte e nevojshme te behen ndryshimet te cilat do pasqyrohen me shtojce, qe do ngarkohet ne sistemin elektronik, si më poshtë:*

#### **Ishte :**

*2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. (Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore). Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

#### **Bëhet:**

*2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2023 sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. (Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore). Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore*

për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Ndryshimin e specifikimeve teknike, si më poshtë:

**Ishte:**

NR	PERSHKRIMI	Mostra	Specifikimet	Njesia	Sasia
5	Dosje arkive me mekanizëm		Kjo dosje me mekanizëm shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet duke i kapur me mekanizëm. Ajo duhet të ketë një mekanizëm metalik, i cili i mban dokumentet të mbërthyer me anë të dy shufrave dopjo në të cilat vendosen letrat A4 pasi janë hapur vrimat përkatëse me hapëse vrimash dopjo ose qeset mbajtëse përkatëse. Gjithashtu, duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Materiali te jete polipropilen me shkelqim. Te jete lehtesisht elastike. Të mbajë jo më pak se 600 fletë me gramaturë 80gm <sup>2</sup> .	cope	400
10	Shina plastike A4 për lidhje dokumentesh		Shina plastike A4 për lidhje dokumentesh 12-16	cope	300
13	Tela/kapëse 24/6; 23/10; 23/13; 23/20		Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë, te galvanizuar dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Të jenë prej metali të kromuar ose të pandryshkshëm. Te kapi deri ne jo me pak se 30 flete te gramatures 80gr/m <sup>2</sup> . Paketimi 1000 copë.	pako	1,000
14	Kapse me vesh 25mm; 32 mm		Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.	pako	100

**Bëhet:**

NR	PERSHKRIMI	Mostra	Specifikimet	Njesia	Sasia

5	Dosje arkive me mekanizëm 6 cm	Kjo dosje me mekanizëm shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet duke i kapur me mekanizëm. Ajo duhet të ketë një mekanizëm metalik, i cili i mban dokumentat të mbërthyer me anë të dy shufrave dopjo në të cilat vendosen letrat A4 pasi janë hapur vrimat përkatëse me hapëse vrimash dopjo ose qeset mbajtëse përkatëse. Gjithashtu, duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Materiali të jete polipropilen me shkelqim. Te jete lehtesisht elastike. Gjerësia e dosjes 6 cm	cope	400
10	Shina plastike A4 për lidhje dokumentesh 12 mm	Shina plastike A4 për lidhje dokumentash 12 mm	cope	300
13	Tela/kapëse 24/6;	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë, të galvanizuar dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Të jenë prej metali të kromuar ose të pandryshkshëm. Te kapi deri në jo me pak se 30 flete të gramatures 80gr/m <sup>2</sup> . Paketimi 1000 copë.	pako	1,000
14	Kapse me vesh 25mm	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.	pako	100

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve*

ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të

*interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 1228 prot., datë 11.03.2024, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor Bashkia Vau i Dejës, ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-97355-03-05-2024, me objekt “Blerje materiale kancelarie”, me fond limit 2,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK
  4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

